



Marrëveshje Nr: 48

Date: 14/01/2026

**Partnerë në marrëveshje janë:**

Drejtoria Rajonale e Shërbimit  
Social Shtetëror Shkoder

OJF THE DOOR

Përfaqësuar nga  
ALMA MEHMETAJ

Përfaqësuar nga  
KASTRIOT FACI

**Neni 1 - Objekti**

1.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet me vullnetin e plotë në mes të dy palëve me qëllim bashkëpunimin në dhurimin e ndihmave humanitare.


Marrëveshja zhvillohet në kuadër të dhurimit materialeve të ndryshme si: karroca për lëvizjen e personave me probleme lëvizshmërie, pako me veshje e këpucë për familje të varfëra, shtresa e mbulesa, dyshekë e materjale të nevojave bazë për familje dhe individë në nevojë që jetojnë në familje apo institucione të përkujdesit social e mjeksor.

**Neni 2 - Kohezgjatja**

2.1 Marrëveshja hyn në fuqi me datë 14 Janar 2026 dhe është e vlefshme për 2 vite, deri me datë 14 Janar 2028.

**Neni 3 - Detyrat dhe përgjegjësitë**

3.1 Objektivi kryesor i kësaj marrëveshje dhe detyrat që duhet të përmbushen janë:





- Bashkëpunimi në mes të palëve në dhurimin të materialeve të ndryshme, ndihma falas në territorin e Qarkut Shkodër, ku veprojnë Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shkodër dhe organizata The Door.

OJF The Door gjen donacionet në mallra dhe bën koordinimin me donatorët për transportin në destinacion në emër të Drejtorisë Rajonale Shërbimit Social Shtetëror Shkodër dhe The Door.



#### **Neni 4 - Kushtet financiare**

4.1 Materialet do të dhurohen dhe nuk do të shiten. Transporti, magazinimi, koordinimi, dhurimi do të jenë kosto që mbulohen nga organizata The Door.

#### **Neni 5 - Përgjegjësia e Paleve**

5.1 Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social Shtetëror Shkodër dhe OJF The Door caktojnë personat përgjegjes për të bërë koordinimin, dhurimin, raportimin dhe kryer të gjitha detyrimet e lindura nga kjo marrëveshje. Shpërndarja e mjeteve ndihmëse për lëvizje të pavarur bëhet nga OJF The Door bazuar në lista, të cilat do ti jepen shoqatës nga Drejtoria Rajonale Shërbimit Social Shkodër dhe rekomandime nga partnerët në marrëveshje që paraqesin kërkesën e tyre dhe dokumentacionin pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër.

Nga kjo ndihmë përfitojnë personat me aftësi ndryshe, me statuse të përhershëm tetraplegjik dhe paraplegjikë si dhe persona të cilët e kanë humbur përkohësisht ose me vështirë lëvizjen e pavarur për shkak të sëmundjeve apo aksidenteve në territorin e Qarkut Shkodër. Personat që kanë humbur përkohësisht ose gjithmonë lëvizjen e pavarur dhe nuk kanë status të vecantë, duhet të ketë si dokument justifikues një rekomandim nga mjeku i familjes, krahas dokumentit të identifikimit dhe libesë pensioni nëse kanë.



## **Neni 6 - Detyrimet**

Të dy palet janë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshje dhe aplikojnë sëbashku për autorizim çdoganimit pranë Drejtorisë së Doganës së Përgjithshme, Dega Shkodër.

Palët paraqesin raportim në fund të çdo 12 mujori duke bërë rakordimet e nevojshme midis kërkesave dhe materialeve të shpërndara.

## **Neni 7 - Dispozitat përfundimtare**

7.1 Të gjitha çështjet që lidhen me përmbushjen e kësaj marrëveshjeje i ngarkohen për Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Rajonal Shkodër Znj. Alma Mehmetaj për OJF The Door Z. Kastriot Faci.

7.2 Në rast moszbatimi ose mosmarrëveshjes në mes të paleve, së pari do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim; në rast të kundërt do t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër.

### **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër**

Përfaqësuar nga  
ALMA MEHMETAJ

D R E J T O R E



### **OJF THE DOOR**

Përfaqësuar nga  
KASTRIOT FACI

D R E J T O R

